



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:012819
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05466464

C-IV-14-7066

Ankuesi

N I I, Gjilan

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55 Lakërishte , Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 15 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI085-3915 të datës 17 tetor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 18 nëntor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. GJI085-3915, të datës 17 tetor 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për kompensimin për “te tjera” në shumë te paspecifikuar nga NSH “Integj” (në likuidim).

Ankuesi pohoi se verifikimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike konsiston në të dhënë se AL nuk është bazuar në provat relevante dhe bindëse me rastin e marrjes vendimit të vetë. AL ka refuzuar kërkesën time me arsyetim se është pas afatit dhe se nuk ka prova dëshmi lidhur me pretendimin tim, edhe pse në dosjen time (në librin amze , librezën e punës dhe lista e punëtoreve të përfitimit të 20 % dëshmojnë se unë kam qenë punëtorë me përvojë 30 vjeçare) në NSH dhe kërkesa ime ka qenë në rubrikën te tjera 5x150 euro. Ndërsa në ankese e precizoj kërkesën 7x 150 euro pasi që me takojnë 7 paga për dëmshpërblim në baze të përvojës së punës .

Ankuesi si provë ka bashkangjitur :

- kopjen e vendimit të AL-së,
- kopjen e librezës së punës,
- kopjen e librit amze të NSH,
- kopjen e listës përfundimtare të përfituesve të 20 %
- letër konfirmimin e NSH se ka qenë punëtorë nga 10.04.1972 deri më 02.03.2006 ,
- listën e punëtorëve të cilët kanë pranuar njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr.753 të 7.12.2006.

Me 14 mars 2024 e paditura AKP parashtrori mbrojtje në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL, ndërsa ankuesi nuk ka identifikuar se cili nen konkret i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL me marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit ishte e pas afatshme ngase ankuesi ka parashtruar kërkesën pas afati i cili ka qenë 12 shkurt 2007 . Më tej e paditura ka theksuar se AL edhe pse kërkesa ka qenë e pas afatshme, me 20 qershor 2014 ka dërguar njoftim ankuesit që të paraqes prova një justifikim në lidhje me dorëzimin me vonës të kërkesës, specifikimin e kërkesës se çka kërkon me të “te tjera” ankuesi nuk i është përgjigjur kërkesës dhe nuk kishte dorëzuar asnjë prove edhe pse njoftimin e kishte pranuar më 26.06.2014. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Arsyvetim ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi nuk e ka dorëzuar kërkesën në Autoritetin e Likuidimit të AKP-së brenda afatit ligjor të shpallur nga ana e AKP-së për parashtrimin e kërkesave kreditore. NSH “Integj ” kishte hyr në proces të likuidimit dhe AKM kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të NSH-së, ku dhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH “Integj ” (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri më datën 12 shkurt 2007.

Nga shkresat e lëndës del se ankuesi kërkesën e tij Autoritetit të Likuidimit ia kishte parashtruar më datë 28 maj 2007.

Nga kjo konstatohet se ankuesi kërkesën e tij te Autoriteti i Likuidimit e kishte parashtruar pasi që kishte kaluar afati i parashtrimit të kërkesave. Edhe pse AL-ja me 20 qershor 2014 ka kërkuar

nga ankuesi te sjell prova, justifikim vonesën e tij, por ankuesi nuk ka sjell asnjë pretendim apo dëshmi të besueshme që do ta justifikonte vonesën e tij në parashtrimin e kërkesës te Autoriteti i Likuidimit.

Nga data e fundit për parashtrimin e kërkesave 12 shkurt 2007, e deri në datën e parashtrimit të kërkesës së tij me 28 maj 2007 në Autoritetin e Likuidimit, ankuesi ka rënë rreth 3 muaj në vonesë të pajustificuar. Andaj, kërkesa dorëzuar në AL me një vonesë të tillë me të drejtë është refuzuar si e pavlefshme, si rrjedhojë e saj edhe ankesa e parashtruar në Dhomën e Posaçme kundër vendimit në fjalë refuzohet si e pabazuar.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton se kërkesat që konsiderohen të jenë të pas afatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligjet e aplikueshme si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo me kohë, refuzohen.

Njëherit një zgjidhje e tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (C-IV-13-0003, C-IV-13-0652, C-IV-13-1754, C-IV-13-2063 dhe AC-I-14-0090) për refuzimin e ankesave kundër vendimeve të AL, në rastet kur kërkesat kreditore janë parashtruar jashtë afatit për paraqitjen e tyre në AL.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi ka paguar taksen gjyqësore .

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha, Gjyqtare